


BULETINI



NR. 4 | PRILL - QERSHOR 2019 |



Buletini Informues Cens 2020 shërben si pasqyrë e aktiviteteve kryesore që INSTAT ka ndërmarrë dhe do të ndërmarrë deri në përfundim të këtij projekti. Ai shpërndalet me frekuencë tremujore. Në numrin e katërt të buletinit paraqiten aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës Prill-Qershor 2019 dhe çfarë pritet të ndodhë gjatë muajve në vijim.

CENSI I POPULLSISË DHE BANESAVE 2020

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) ka planifikuar të kryejë Cens-in e ardhshëm të Popullsisë dhe Banesave në vitin 2020. Cens-i i Popullsisë dhe Banesave 2020 do të ndjekë metodën e numërimit të drejtpërdrejtë universale bazuar në operacionet në terren me përpilimin e pyetësorëve nga anketuesit, duke përdorur metoda të reja për mbledhjen e të dhënave.

KONTAKTET:

- Menaxhimi i Projekteve
- Teknologjia e Informacionit
- Komunikimi
- Gjeoinformacioni dhe Logjistika

gbaja@instat.gov.al
hmitre@instat.gov.al
axhikneli@instat.gov.al
nlecini@instat.gov.al
eshameti@instat.gov.al

PËRMBAJTJA

Aktivitetet e CENS 2020, Prill-Maj-Qershor 2019

- Përzgjedhja e Logos së Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020
- Mision mbi hartimin e strategjisë së komunikimit për Cens 2020
- Anketa e përditësimit të hartave të zonave të Cens 2020
- Misioni i dytë nga BE në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020
- Takim (Kick off-meeting) me kompaninë fituese "GOPA Consultants"
- Finalizimi i pyetësorit standard dhe i banesave kolektive



AKTIVITETE MBI KOMUNIKIMIN

Përzgjedhja e Logos së Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020

Me datë 3 Maj 2019, Instituti i Statistikave (INSTAT) në bashkëpunim me UNFPA, organizoi aktivitetin për ndarjen e çmimeve për fituesit e konkursit të logos së Cens 2020. Të pranishëm në këtë event ishin Drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT, Znj. Delina Ibrahimaj dhe Z. Brian Williams Koordinator i Përhershëm i OKB-së në Shqipëri.



Logo fituese është logo që do të shoqërojë të gjithë procesin e Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020. Tomas Kuka, student i vitit të tretë për Komunikim & Dizajn, u shpall fitues i këtij konkursi.

[Aktiviteti i Përzgjedhjes së Logos së Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020](#)

Mision mbi hartimin e strategjisë së komunikimit për Cens 2020



Në datat 10 - 13 Qershor 2019, në ambientet e INSTAT erdhi një mision mbi strategjinë e komunikimit për Cens 2020. Qëllimi i misionit ishte hartimi i strategjisë së komunikimit, duke vlerësuar situatën aktuale të vendit dhe mundësitë e reja që ofrohen nga Cens 2020. Gjatë misionit u zhvilluan takime me përfaqësues të minoriteteve dhe grupeve të interesit.

Në përfundim të misionit, eksperti ofroi një plan mbi hartimin e strategjisë së komunikimit për Cens 2020.

Manuali i Vizibilitetit dhe Planit të Komunikimit për Cens Pilot 2020



Gjatë periudhës Prill - Qershor 2019 është përgatitur Manuali i Vizibilitetit duke ndjekur udhëzimet e Komisionit Evropian për përfituesit e fondeve IPA.

Qëllimi i Planit të Komunikimit dhe Vizibilitetit është të sigurojë që çdo lloj komunikimi të jetë në përputhje me normat dhe rregulloret e INSTAT-it dhe BE-së, dhe të sigurojë komunikim të vlefshëm për rëndësinë e Censit, duke informuar palët e interesuara dhe publikun për ndikimin që do të ketë ky projekt në jetën e tyre.

Manuali i Vizibilitetit është në fazën e finalizimit dhe do të shërbejë edhe për planin e komunikimit në fazën pilot të Cens 2020.

MENAXHIMI I PROJEKTEVE

Misioni i dytë nga BE në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020

Në datat 03 - 07 Qershor 2019, në ambientet e INSTAT erdhi misioni i dytë me ekspertë të kontraktuar nga Delegacioni Evropian në Shqipëri, me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e punës përgatitore për Cens 2020, si dhe angazhimin e të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, për të siguruar mbarëvajtjen e aktiviteteve të Cens-it 2020. Gjatë misionit janë zhvilluar takime me antarët e çdo njësie të grupit të punës së Cens-it në lidhje me ecurinë e aktiviteteve që mbulojnë. Në përfundim të misionit ekspertët përgatisin raportet e monitorimit duke lënë rekomandime/këshilla si për kuadrin ligjor ashtu edhe për aspektet operacionale dhe teknike të aktiviteteve të Cens-it.

Nënshkrimi i kontratës së Asistencës Teknike për Cens 2020



të Popullsisë dhe Banesave 2020.

Gjatë muajit Qershor 2019, është finalizuar procedura e prokurimit për kontratën e shërbimit "Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020". Në datë 21 Qershor 2019 është nënshkruar kontrata me kompaninë fituese "GOPA Consultants", e cila do të sigurojë asistencë teknike dhe ngritje kapacitetesh për zbatimin e aktiviteteve të Censit

Takimi i parë/Kick off në kuadër të asistencës teknike për Cens 2020



Në datë 03 Korrik 2019, në ambientet e INSTAT, në kuadër të projektit "Mbështetje për Zbatimin e aktiviteteve të Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020" u organizua takimi i parë/Kick off. Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues të INSTAT, të Delegacionit Evropian në Shqipëri, të Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE, BB dhe Donatorëve të tjerë (CFCU) si dhe grupi i ekspertëve kontraktuar nga kompania "GOPA Consultants".

Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i palëve të përfshirë në projekt, të cilët do të ndjekin zbatimin e tij, si nga ana operacionale ashtu edhe ajo kontraktuale.

Rekrutohet stafi i nevojshëm për Censin 2020

Në kuadër të fazës parapërgatitore të projektit Cens 2020, për periudhën Mars - Qershor 2019, janë punësuar staf shtesë me kontratë, si anketues GIS, operatorë, specialist prokurimi, specialist dizanjer, specialist programist IT dhe specialist GIS. Është ngritur zyra e Koordinatorëve të Projektit Cens, me 3 koordinator.

INSTAT ka zhvilluar aplikacionin e procedurave të rekrutimit online <http://rekrutime.instat.gov.al>, dhe duke filluar nga data 10.05.2019, aplikimet për pozicionet vakante në Shërbimin Civil si dhe të atyre mbështetës me kontratë të përkohshme bëhen online në faqen e web-it të INSTAT-it.

Finalizimi i pyetësorit standard dhe i banesave kolektive

Pyetësori standard dhe ai i banesave kolektive janë finalizuar. Versionet finale të tyre janë përgatitur sipas formatit që do të përdoret për CAPI, shoqëruar me kontrollet logjike, të cilat janë thelbësore për ndërtimin e aplikacionit të mbledhjes së të dhënave. Do të jenë këto versione që do të përdoren dhe testohen për mbledhjen e të dhënave në Cens Pilot. Referuar versioneve finale të pyetësorëve, punës me hartat, rolit dhe detyrave, që do të performojë një anketues si dhe përdorimit të mjeteve (tabletave) për mbledhjen e të dhënave, u përgatit draft manuali i anketuesit.


Aplikacioni i mbledhjes së të dhënave për Cens Pilot 2020

Gjatë muajve Prill – Qershor 2019 u zhvillua nga njësia e IT për anketuesit, aplikacioni CAPI për mbledhjen e të dhënave. Faza e testimit është ndër fazat më të rëndësishme të zhvillimit të aplikacionit pasi nëpërmjet përmirësimeve që mund të bëhen gjatë kësaj faze, shmangen gabimet që mund të sjellin kosto në proceset e mëtejshme të analizimit dhe përpunimit të të dhënave. Aplikacioni CAPI për anketuesit u testua në lidhje me funksionalitetin (mbledhjen e të dhënave, kontrollet logjike), përdorimin (navigimi dhe përmbajtja), paraqitjen (p.sh. të sigurohemi që mesazhet e gabimeve shfaqen siç duhet), me performancën (si vepron aplikacioni në rast kur tableti apo vetë aplikacioni bën crash), me sigurinë (identifikimin e anketuesve). Nga testimi u evidentuan mangësi të cilat do të reflektohen në versionet e mëtejshme.

Gjatë gjithë procesit të realizimit të Cens-it, cilësia e të dhënave të mbledhura është vetëm një prej dimensioneve që është e nevojshme të merret në konsideratë, pasi të dhënat e besueshme varen edhe nga saktësia dhe besueshmëria e të gjitha fazave. Në këtë kuadër është përgatitur versioni draft i strategjisë për Sigurimin e Cilësisë së Cens 2020 (Quality Assurance). Në strategji përshkruhen masat dhe procedurat kyçe për sigurimin e cilësisë që do të ndërmerren nga INSTAT.

GJEOINFORMACIONI DHE LOGJISTIKA

Anketa e përditësimit të hartave të zonave të Cens 2020



Më 01 Prill 2019, në zbatim të planit të punës dhe përgatitjeve për Cens 2020, filloi Anketa e përditësimit të hartave të zonave të Censit. Anketa është një nga aktivitetet kryesore në fazën përpara Censit dhe në periudhën Prill-Qershor 2019 puna ka shkuar sipas parashikimit, ku janë përditësuar rreth 30 % e të gjithë zonave të Censit.

Së bashku me punën në terren, ka vijuar dhe kontrolli i punës nga operatorët GIS, nëpërmjet një aplikacioni të posaçëm, "Dashboard", që mundëson, shpërndarjen e punës tek çdo anketues, statusin e përditësimit, kontrollin e punës, si dhe ndjekjen në kohë reale të punës së çdo anketuesi.

Përcaktimi i zonave (ZC) për Cens Pilot 2020

Në kuadër të Cens-it Pilot 2020, janë përcaktuar dhe aprovuar zonat (ZC) në të cilat do të kryhet projekt piloti, sipas disa kriterëve të paracaktuara më parë nga njësia e metodologjisë. Është bërë përditësimi në terren i zonave pilot të Cens nga anketuesit në 95 % të këtyre zonave. Numri i familjeve që do të anketohen është 12.500. Në këtë kuadër, është duke u zhvilluar faza e kontrollit të cilësisë në terren "quality control" për zonat pilot dhe do të fillojë faza e përditësimit (editing) të të dhënave gjeohapësinore. Tabela e mëposhtme përmbledh shpërndarjen e zonave të Cens-it pilot për Bashki.

Qarku	Bashkia	Zona Pilot për Bashki
DURRËS	DURRËS	20
KORÇË	KOLONJË	10
KORÇË	MALIQ	8
KORÇË	PUSTEC	2
KUKËS	KUKËS	10
SHKODËR	MALËSI E MADHE	2
SHKODËR	SHKODËR	12
TIRANË	TIRANË	20
VLORË	HIMARË	2
VLORË	VLORË	14

Draft-plan për logjistikën e Cens 2020

Gjatë muajve Prill – Qershor 2019 u hartua draft-plani për logjistikën e Cens 2020 dhe është drejt finalizimit përshkrimi i detyrave të personave të angazhuar në terren për njësitë e Cens në nivele Qarku dhe Bashkie. Janë njoftuar Zyrat Rajonale për shpërndarjen gjeografike të zonave të numërimit.

Njësia e Burimeve Njerëzore në kuadër të realizimit të aktiviteteve të Cens 2020, gjatë periudhës 01.05.2019-01.06.2019 ka përfunduar përshkrimin e detyrave për anketuesit, kontrollorët dhe supervizorët që do të angazhohen në Cens-in Pilot.

Aktivitetet e parashikuara për periudhën Korrik – Shtator 2019

Gjatë 3 mujorit të tretë 2019, do të zhvillohen aktivitetet e mëposhtme:

- Organizimi i Takimit të Komitetit Drejtues (SCM) për kontratën e grantit "Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020, në Shqipëri" si dhe për Asistencën Teknike të kontraktuar në kuadër të Grantit.
- Misioni i tretë monitorues i ekspertëve të kontraktuar nga Bashkimi Evropian, për të monitoruar dhe vlerësuar punën përgatitore të Cens-it pilot.
- Organizimi i konferencës për lancimin e kontratës së asistencës teknike në kuadër të mbështetjes që Bashkimi Evropian ka dhënë për Cens 2020.
- Rekrutimi i anketuesve, supervizorëve dhe stafit mbështetës IT
- Trajnime për të gjithë strukturat e angazhuara në Cens-in Pilot, si trajnimi i stafit të INSTAT, trajnimi i stafit mbështetës IT dhe GIS të rekrutuar, trajnimi i supervizorëve, kontrollorëve dhe anketuesve.

- Fillimi i fushatës së komunikimit, e cila do të përfshijë organizimin e tryezave të rrumbullakëta, organizimin e intervistave në TV dhe Radio, përgatitjen e fletëpalosjeve informuese si dhe përgatitjen e posterit të Censi-it Pilot.
 - Përgatitja e manualit për anketuesit, kontrollorët, supervizorët, koordinatorët dhe stafin mbështetës IT. Në datën 15 Gusht 2019 do të finalizohen të gjithë manualet për anketuesit.
 - Testimi dhe monitorimi i aplikacionit CAPI për kontrollorët dhe supervizorët, do të testohet dhe monitorohet i gjithë procesi, si dhe do të nis përgatitja e tabletave për mbledhjen e të dhënave në terren.
 - Inventarizimi dhe depozitimi i materialeve që duhen për trajnimet dhe për punën në terren.
-